



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 915/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e Muhamet Xhafa, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Vushtri, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

#### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.915/2021, i paraqitur nga Muhamet Xhafa, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Vushtri, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet: 2708B/2R dhe 270B/01R për kandidatët e kuvendit komunal në Vushtrrisë nga subjekti politik PDK.

#### A r s y e t i m

Me datë 04.11.2021, Muhamet Xhafa, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Vushtri paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ka parashtruar apel me të cilin pretendon se vota e tij dhe e familjareve të tij nuk figurojnë në rezultatet e shpallura nga KQZ. Më tej në apel parashtruesi shton se në VV 2708B/2R sipas vëzhguesit të vendvotimit ka pasur parregullsi, po ashtu në VV 2708B/01R sipas vëzhguesit ka pasur manipulime të votave. Si provë në apel parashtruesi ka bashkangjitur deklarata të vëzhguesve.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin, si dhe shkresat e lëndës vlerësoi se:

### **Apeli është i pabazuar.**

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave dhe parregullsi, në bazë të cilave ka kërkuar rinumërim të fletëvotimeve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave të parashtruesit të apelit gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultat përfundimtar, si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankueses nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli i shqyrtoi deklaratat e vëzhguesve të bashkangjitura në apel nga ana e ankuesit, gjeti se të njëjtat nuk janë bazë e mjaftueshme për të konkluduar se në këto vendvotime ka pasur parregullsi, rrjedhimisht pretendimi ankimor i parashtruesit të apelit se apelin e mbështet në pohimet e familjarëve dhe vëzhguesve nuk është i argumentuar, për më tepër, paneli rikujton se vota është e fshehur, dhe publikimi i saj shpërfaq vullnetin e çdo votuesi në fletëvotim që është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si fakt provues pretendimi i tillë se një votues pohon faktin se ka votuar në ndonjërin nga vendvotimet që kandidatja ka pretenduar në apel. Në rastin konkret apeli nuk ka paraqitur ndonjë provë tjetër si Formularët e Përputhjes së Rezultateve dhe Formularët e Rezultateve të Kandidatëve, të cilët do shërbenin si provë, andaj në mungesë të provave paneli vendosi që apeli i paraqitur të refuzohet si i pa bazuar.

Apeli i ankuesit u refuzua lidhur me kërkesën për rinumërim të VV me nr. 2708B/01R të lartcekur, pasi që sipas evidencës zyrtare të KQZ-së të gjitha fletëvotimet në këto VV, për të gjithë kandidatët e Subjektit Politik PDK, janë rinumëruar dhe nuk mund të rinumërohen edhe një here. Ndërsa sa i për ketë VV 2708B/2R sipas evidencës në KQZ, nuk ekziston.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i Muhamet Xhafa, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Vushtri, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat apo ndonjë

parregullsi, andaj kërkesa e apeluesit për të rinumëruar të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për kuvend komunal në Komunën e Vushtrrisë, për Subjektin Politik PDK, vlerësohet si i pa bazuar, sipas vlerësimit të panelit shkeljet do duhej të jenë shumë serioze dhe bindëse, si dhe të rezultojnë nga provat e mjaftueshme, bindëse dhe të pa kontestueshme, te cilat në rastin konkret mungojnë.

Për arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr 915/2021 më datën 07.11.2021

**Kryesuese e Panelit**

Milana Đerić



***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*